

VENDIM
Nr.238, datë 7.4.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.565, DATË 9.8.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MBROJTJEN E SHITRESAVE NË NEVOJË NGA RRITJA E
ÇMIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 1 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, të Ministrit të Financave, të Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5 e vendimit nr.565, datë 9.8.2006 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Masa e kompensimit, për çdo përfitues, është 640 (gjashtëqind e dyzet) lekë në muaj. Efekti financiar i shtesës së kompensimit për çdo përfitues të përballohet nga fondet e miratuara në buxhetin e vitit 2010, për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.”.

2. Ministria e Financave të bëjë rishpërndarjen e këtij fondi, sipas kërkesës së çdo institucioni qendror.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha